



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
MINISTRI

Nr. 11964 Prot.

Tiranë, më 16 . 11 . 2018

UDHËZIM

NR. 34 , DATË 16 . 11 . 2018

PËR  
NDALIMIN E TELEFONIT CELULAR NË INSTITUCIONET ARSIMORE  
PARAUNIVERSITARE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 26 të ligjit. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në mjediset e institucioneve arsimore parauniversitare, është e ndaluar të disponohet telefon celular nga nxënësit dhe mësuesit.
2. Në rast konstatimi të disponimit të telefonit celular nga nxënësit në mjediset e institucioneve arsimore parauniversitare, drejtorja e institucionit:
  - a) Sekuestron telefonin celular dhe zbaton masa disiplinore, sipas kuadrit ligjor në fuqi. Telefonat e sekuestruar depozitohen pranë institucioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar,
  - b) Masat e marra ndaj nxënësit i njoftohen me shkrim prindit ose kujdestarit ligjor të nxënësit.
3. Drejtoritë e institucioneve arsimore:
  - a) Të rishikojnë rregulloren e brendshme të shkollës, duke përcaktuar masat për ndalimin e telefonit celular nga nxënësit dhe mësuesit, në mjediset e institucioneve arsimore parauniversitare;
  - b) Të marrin masa për të organizuar takime me prindërit për njohjen me rregulloren e re;
  - c) Të vendosin në çdo klasë poster për ndalimin e telefonit celular;
  - d) Të sigurojnë nënshkrimin e deklaratës së përbashkët të mësuesit të klasës me prindin ose kujdestarin ligjor, për ndalimin e marrjes së telefonit celular në mjediset e shkollës nga nxënësit;

- e) Të marrin masa për të vënë në dispozicion numër telefoni të veçantë për komunikimin me prindërit e nxënësve dhe t'ua bëjnë me dije prindit në deklaratën e përbashkët;
- f) Të raportojnë me shkrim pranë institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, për masat e marra ndaj mësuesit, në rast të përdorimit të telefonit celular gjatë procesit mësimor.
4. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar:
- a) Të monitorojnë masat e marra nga institucionet arsimore për ndalimin e telefonit celular nga nxënësit dhe mësuesit, në mjediset shkollore;
- b) Të depozitojnë pranë Policisë së Shtetit, telefonat celular të sekuestruar nga shkollat;
- c) Të raportojnë çdo muaj me shkrim në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për zbatimin e këtij udhëzimi.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, si dhe drejtoritë e institucioneve arsimore.

*Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në fletoren zyrtare.*

**MINISTËR**

*Lindita Nikolla*

**Lindita Nikolla**

